



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 15 pika 1 dhe 2, neni 17 pika 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Udhëzimit Administrativ 1/2015,

## **Gjykata Themelore në Ferizaj** **Shpall**

### **K O N K U R S**

**Nr.07/2017**

**1. Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional - Gjykata Themelore në Ferizaj ----- 3 (tri) pozita.**

**Titulli i pozitës: Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Kategoria Funktionale: Niveli Profesional**

**Koeficienti: 8**

**Lloji i Vendit të Punës: Pa afat të caktuar, me orar të plotë**

**Raporton tek: Kryetari i Gjykatës**

**Qëllimi i vendit të punës: Mbështetje profesionale për gjyqtarët dhe ndihmon në përgatitjen e memorandumeve, vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve tjera duke siguruar materiale të domosdoshme juridike, duke bërë shqyrtimin e ligjeve etj.**

**Detyrat Kryesore:**

1. Prezanton në seanca gjyqësore të lëndëve civile, penale dhe kundërvajtëse,
2. Ndihmon në raste të tilla duke marrë shënime, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike,
3. Ndihmon në draftimin e vendimeve gjyqësore (aktgjykime, aktvendime, urdhëresa),
4. Ndihmon në përgatitjen e memorandumeve të ndryshme,
5. Angazhohet në procedurat për zgjidhjen alternative të kontesteve gjyqësore,
6. Bënë hulumtimin e praktikave gjyqësore të dobishme për punën e Gjykatës,
7. Bënë anonimizimin e vendimeve gjyqësore dhe
8. Kryen punë të tjera sipas nevojës.

**Shkathtësitë e kërkuara:**

1. Të ketë shkathtësi të dëshmuara ndër personale ----- e nevojshme,
2. Komunikim të shkëlqyeshëm me shkrim dhe me gojë ----- e nevojshme,
3. Aftësi të kryej hulumtime gjyqësore ----- e nevojshme,
4. Njohuri në procedurat e gjykatave ----- e nevojshme,
5. Tre (3) vite përvojë pune në lëmin juridike ----- e nevojshme,

**Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:**

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik ----- e nevojshme,
- Provimin e dhënë të Jurisprudencës ----- e nevojshme.

**VEREJTJE:**

- Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil Nr.03/L-149 dhe Rregulloren, Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil.

**Konkursi është publikuar me datë 09.11.2017 dhe mbyllet me datë 23.11.2017.**

**Aplikacionet mund t'i merrni në Zyrën e pranimit në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Rr. Dëshmorët e Kombit” pn. dhe po ashtu, aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web portalin e Gjykatës Themelore në Ferizaj: [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org) .**

[Shkarko Aplikacionin](#)

**Aplikacionet e plotësuara mund t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Rr. Dëshmorët e Kombit” pn. si dhe përmes postës - kodi postar 70.000.**

- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, si specifikohet në Nenin 11, par.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

**Aplikacioni e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.**

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkurron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata që nuk jeni nën hetime, certifikata e përvojës së punës, certifikata të tjera, vërtetime, dy rekomandime etj.

**Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.**

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.
  - Njoftohen kandidatët të cilët aplikojnë për pozitën Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në Gjykatën Themelore në Ferizaj se të gjitha njoftimet (informatat) lidhur me procedurën rekrutuese për pozitën në fjalë do të gjeni në **Web portalin e Gjykatës Themelore në Ferizaj: [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)** . dhe në tabelën e njoftimeve të kësaj Gjykate.
  - Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësie mund të kontaktoni në numrat e tel. fiks: **0290/ 321 009 dhe 0290/ 320 261.**
- Për të gjithë rrjedhën e procedurës rekrutuese për pozitën e lartë cekur, kandidatët pjesëmarrës do të njoftohen përmes Web portalit të Gjykatës Themelore në Ferizaj: [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org), si dhe përmes njoftimit në tabelën e njoftimeve të kësaj Gjykate.